




REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO  
 AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT  
 AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE  
 ANTI-CORRUPTION AGENCY

Dep. \_\_\_\_\_  
 Dep. 03-02/OPK  
 Nr. i faq. \_\_\_\_\_  
 Broj stranica \_\_\_\_\_  
 Nr. pages 02

Nr. Prot. \_\_\_\_\_  
 Br. Prot. 01-1213/16  
 Prot No. \_\_\_\_\_  
 Data \_\_\_\_\_  
 Datum 23-03-2016



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**

**AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT**  
**AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE**  
**ANTI - CORRUPTION AGENCY**

Në mbështetje të nenit 11 (paragrafi 1.1), nenit 5 (paragrafi 1 pika 1.5), nenit 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, si dhe nenit 19 (paragrafi 11) të Rregullores nr. 01/2014 së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 23.03.2016, mori:

**V E N D I M**

**I.** Mbyllet rasti me nr. AKK– 03-02-4248/15, për z. Valbon Bytyqi – Drejtor i Departamentit të Auditimit në Zyrën e Auditorit të Përgjithshëm, të dyshuar për konflikt interesi lidhur me ushtrimin e funksioneve tjera krahas funksionit publik, për shkak se nuk ka të dhëna të mjaftueshme që argumentojnë dyshimin e arsyeshëm për ekzistimin e konfliktit të interesit.

**II.** Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

**A r s y e t i m**

**I.** Rasti i hapur nën dyshimin për konflikt interesi për z. Valbon Bytyqi – Drejtor i Departamentit të Auditimit në Zyrën e Auditorit të Përgjithshëm i dyshuar për konflikt interesi lidhur me ushtrimin e funksioneve tjera krahas funksionit publik, është trajtuar sipas procedurës së paraparë në Ligjin Nr. 04/L-051 për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik (më tutje Ligji PKI).

Pas pranimit të informacionit nga denoncuesi i këtij rasti, Agjencia kundër Korrupsionit ka kërkuar dokumentacionin dhe informacionet e tjera relevante si dhe ka organizuar takim me z. Bytyqi.

Dyshimet për konflikt interesi kanë qenë sepse, sipas denoncuesit të rastit, z. Bytyqi, krahas funksionit publik ushtron funksione tjera në disa organizata, jashtë Zyrës së Auditorit, siç janë: Instituti për Kontabilitet dhe Auditim (KAF), Source Accounting NSH dhe NTSH Electra.

Pas mbledhjes dhe analizimit të dokumentacionit nga Agjencia për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë, AKK ka konstatuar se z. Bytyqi nuk ushtron funksione menaxhuese në bizneset private “Source Accounting” dhe “Electra” ndërsa në Institutin KAF z. Bytyqi është Bashkëpunëtor



Profesional për çështje të Kontabilitetit dhe Auditmit. Kjo është konfirmuar nga Kontrata e Punës që z. Bytyqi ka me këtë Institut.

Po ashtu, nga Kontrata e Punës kemi kuptuar se marrëdhënia e punës në këtë Institut është me orar jo të plotë, pjesa më e madhe ditëve të shtune.

Ligji PKI nuk e ka ndaluar ushtrimin e funksioneve të natyrës së tillë krahas funksionit publik, përveç nëse paraqitet konflikti “rast për rast” i interesit, në ndonjë vendimmarrje të veçantë. Në raste të tilla zyrtari i lartë është i obliguar të deklaroj dhe të shmang konfliktin e interesit.

Ky obligim rrjedh nga nenin 13 i Ligjit PKI, i cili përcakton se:

- 1. Çdo zyrtar i lartë gjatë ushtrimit të funksionit të tij publik, në bazë të njohurive të tij dhe në mirëbesim, detyrohet që të bëjë vet deklarinë paraprak, rast për rast, të ekzistencës së interesit të tij privat lidhur me vendimmarrjen në një çështje të caktuar, që mund të bëhen shkak për lindjen e një konflikti të interesit.*
- 2. Deklarimi rast për rast i interesave private bëhet çdo herë nga zyrtari i lartë, kur kjo kërkohet nga eprori ose nga institucioni mbikëqyrës. Deklarimi si rregull duhet kërkuar dhe bërë paraprakisht. Kur kjo nuk është e mundur ose kur nuk ka ndodhur, deklarimi duhet të kërkohet të bëhet sa më shpejt që të jetë e mundur.*
- 3. Vetë deklarimi si rregull bëhet me shkrim, kur zyrtari i lartë përfshihet në një vendimmarrje për ndonjë çështje të caktuar.*

Andaj, në pajtim me këto dispozita, duke marrë parasysh të gjitha faktet dhe rrethanat relevante që i posedojmë në lidhje me çështjen e konfliktit të interesit për këtë rast, vlerësojmë se nuk ka të dhëna të mjaftueshme që argumentojnë dyshimin e arsyeshëm për ekzistimin e konfliktit të interesit dhe papajtueshmërisë në ushtrimin e funksionit publik.

II. Në mbështetje të nenit 18 (paragrafi 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik;
- Drejtorit të DPK- së;
- Z./znj. (zyrtarit përgjegjës).

Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit

Hasan Preteni

